

Veprimtaria e UMSH-së gjatë vitit 2015 në qëndër dhe në bazë

Dr. Fatmir BRAHIMAJ

President

Viti i kaluar (*periudha pas zgjedhore*) do të vlerësohej një vit i vështirë përpjekjesh, angazhimesh e punë të vazhduar nga të gjithë të zgjedhurit dhe punonjësit e tjerë në të tëra strukturat tona, kryesisht në dy drejtime:

Ristrukturimi, gjallërimi, forcimi i veprimtarisë të strukturave, duke garantuar në punën e tyre vazhdimësi dhe normalitet.

Përballimi i veprimeve, tendencave, synimeve, ndërhyrjeve për të kufizuar apo eliminuar pavarësinë tonë, që do të çonte në vënien nën kontroll, duke minimizuar apo eliminuar funksionin dhe misionin e UMSH-së.

Dua të theksoj se në çdo veprim tonë në të dyja drejtimit e mësipërme, ne jemi udhëhequr, orientuar dhe mbështetur së pari në ligj dhe në dokumentat tona të hartuara, bazuara dhe të dala nga detyrimet ligjore, në përputhje me qëllimin, misionin dhe funksionin e UMSH-së, si dhe në përvojën e grumbulluar në të gjithë veprimtaritë tona brenda dhe jashtë vendit.

I. Veprimtaria jonë e përbashkët fillon me studimin e ligjit të ri për UMSH-në dhe ndërtimi i planeve të punës për implementimin e tij.

1-Risia e parë ishte krijimi i Urdhri i Stomatologëve.

Për këtë u dhanë porosi të inventarizoheshin dosjet dhe të gjitha dokumentat e tyre. Këto u dorëzuan tek Urdhri i Stomatologut sapo ata u bënë gati për t'i marrë në dorëzim.

2-Njohja me ndryshimet në ligjin e ri, si dhe me plotësimin e detyrimeve që përcaktoheshin në të. Hartimi i dokumentave të reja bazë:

1. U përgatit dhe u aprovua Statuti i ri.

Rregulloret e reja:

1. Gjykimin disiplinor profesional dhe trupat e reja për gjykimin (*që do të miratohen sot*).
2. Përgatitja e një programi të ri kompjuterik për regjistrimin, si dhe është pothuajse gati rregullorja e re për regjistri- liçensimin.
3. Është punuar për rishikimin e rregullores së re të veprimtarisë financiare.
4. Vazhdon puna paralel për rishikimin e rregulloreve për funksionimin e Aparatit Qëndror, atë të Këshillit Kombëtar, si dhe të Këshillave Rajonale.

* Ndër gjërat e para që unë u angazhova personalisht ishte analiza e fushatës zgjedhore, me të cilën jemi njohur nëpërmjet numrit të rradhës së Buletinit. Njëkohësisht u punua për riorganizimin e punës, si në aparatit qëndror, ashtu edhe në bazë. Në këtë kuadër, u bë për çdo sektor, zyrë dhe individ ndarja konkrete dhe specifikimi i detyrave në përputhje me rregullat dhe statutin, u kërkuar hartimi i planeve të punës, si dhe bërja e bilanceve në afate kohore të ndryshme (njëkohësisht çdo fillim muaji analizohej puna e bërë në çdo muaj të mëparshëm). U riorganizua redaksia e Buletinit të UMSH-së, si dhe u caktua një korrektor letrar. Për të arritur tek sa më shumë lexues buletini do të hidhet rregullisht në internet.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar marrëdhënieve ndërinstitucionale.

Së pari me ato institucione që na detyron ligji të bashkëpunojmë. Me to është folur për vazhdimësinë e Memorandumeve të Bashkëpunimit që kanë ekzistuar duke e lënë të hapur edhe rishikimin apo përsëritjen e tyre. Sigurisht është kontaktuar, diskutuar dhe bashkëpunuar për probleme konkretisht me interes të ndërsjelltë. Prioritet dhe vëmendje të veçantë ka patur bashkëpunimi dhe partneriteti me institucionet shëndetësore, edhe pse jo për fajin tonë ato nuk janë në nivelin që ne dëshirojmë ti kemi.

Me synimin për të qënë sa më shumë profesional, të saktë dhe racional në drejtim të vetërregullimit profesional, rëndësi e veçantë i është kushtuar tërheqjes së mendimit nga bashkësia e mjekëve, përfaqësuesëve të shoqatave mjekësore të specialiteteve të ndryshme, si dhe personaliteteve mjekësore shqiptare (për këtë janë iniciuar disa takime). Këto mendime në përputhje me misionin dhe funksionin tonë, ne i kemi sygjerruar në momentet e duhura në Komisionin Parlamentar përkatës, në takimet në ministri, në borde, si dhe në grupe pune, në biseda televizive apo intervista në media kudo ku janë dashur të shprehen mendimet tona.

Në të gjitha këto veprimtari kryesisht jemi përqëndruar në problemet e EVM-së, ruajtjen e tipareve bazë që na përcakton ligji si të pavarur, jo politik dhe thellësisht profesional.

Vëmendjen e merituar kanë patur edhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Gjatë kësaj periudhe, UMSH-ja është përfaqësuar me delegacione të ndryshme në disa nga veprimtaritë më të rëndësishme. Po ashtu, ne ishim pritësit e Takimit ZEVA në Shtator, në Tiranë, ku u realizua një veprimtari dinjitoze falë angazhimit të gjithë sektorëve të aparatit qëndror. Krahas diskutimit, shkëmbimit të përvojave, me shumë rëndësi ishte lobimi, argumentimi, sqarimin dhe sigurimin e mbështetjes ndërkombëtare për problemet me interes të veçantë për ne (ju jeni njohur me to) nëpërmjet shtypit apo buletinit tonë.

Përsa i përket punës me Këshillat Rajonale, për të ndihmuar dhe vlerësuar punën e tyre kemi dërguar grupe, porosi dhe udhëzime, urdhëresa e dokumenta të tjera, takime me mjekë dhe drejtues lokal.

Së shpejti do të organizojmë 2 seminare *(me presidentët e Këshillave Rajonale dhe sekretarët e tyre, si dhe një tjetër me trupat e gjyqimit disiplinor profesional (shkalla e parë dhe Apeli).*

Nga veprimet rutinë në të gjitha Këshillat Rajonale gjatë vitit të kaluar janë bërë:

- Regjistrime për mjeket e rinj dhe të huaj 333.
- Riliçensime rreth 1682.
- Ankesa 29 nga të cilat 13 janë të zgjidhura, 10 në gjykim disiplinor dhe 6 në organet e drejtësisë.

Edhe pse puna është e kënaqshme dua të tërheq vëmendjen për :

- *Njohjen më të mirë të ligjit dhe të dokumentave bazë të UMSH-së.*
- *Hartimin e planeve të punës.*
- *Të ndihen më shumë Këshillat Rajonale në të gjithë veprimtarinë shëndetësore, si dhe në publik.*

II. Përballimi i veprimeve, tendencave, synimeve, ndërhyrjeve për të kufizuar apo eliminuar pavarësinë tonë, që do të çonte në vënien nën kontroll duke minimizuar apo eliminuar funksionin dhe misionin e UMSH-së.

Këto prire u shfaqën direkt pas debateve të bëra nga drejtuesit e UMSH-së me Ministrinë e Shëndetësisë për problemin e testimit të mjekëve (janë të qarta pozicionet e të dy palëve). Kështu fushata zgjedhore filloi me një atmosferë jo të mirë, me mungesë komunikimi midis UMSH-së dhe MSH-së, por me një interes mjaft të gjerë të bashkësisë së mjekëve dhe shumë drejtuesve të institucioneve shëndetësore që morën pjesë si vëzhgues në zgjedhje. Siç kemi theksuar gjatë zgjedhjeve u duk një tendencë për politizimin e strukturave dhe veprimtarive tona, por ne e konsideruam atë si tendencë të individëve të veçantë. Në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme për

zgjedhjen e Këshillit Kombëtar dhe Presidentin e ri u duk qartë se strukturat shtetërore kërkonin me çdo kusht vënien në kontroll të Urdhrit. Edhe pse kishte shkelje të ligjit dhe më pas zhvillimi i gjyqit ku përfaqësuesja e ministrisë (si palë e 3^{të} në procesin gjyqësor) doli hapur duke paraqitur gjithmonë pseudo argument duke mbrojtur qartë kandidaten e tyre të preferuar.

Pas humbjes së Gjyqit në shkallën e parë ne bëmë veprimet e mëposhtme:

- Mbledhje e jashtëzakonshme me Këshillin Kombëtar, deklaratë për publikun dhe të gjitha institucionet shqiptare;
- Informim Komisionit Parlamentar të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë;
- Kërkuam mbështetje nga partneret homologe ndërkombëtar (letër drejtuar atyre, kontakt direkt në aktivitetet ndërkombëtare);
- Publikimi i dokumentave të ndryshme mbështetëse;
- Apeli i vendimit gjyqësor të datës 15 Tetor në Gkatën Administrative të Apelit dhe jemi në pritje;
- Avokati i Popullit.

Mendoj se bashkësia e mjekëve duhet të kishte bërë më shumë për t'u shprehur në mbrojtje të Urdhrit

Përveç këtij momenti, tendencat kanë vazhduar në forma të tjera që sigurisht veç të tjerash ndeshen edhe me ligjin për UMSH-në *(ku saktësohet pavarësia e këtij institucioni)*. Duke vazhduar në frymën e marrëdhënieve jo të mira me institucionet shëndetësore shtetërore. Në Dhjetor 2015, Ministria e Shëndetësisë së bashku me atë Arsimit me një urdhër të përbashkët, krijuan një grup kontrolli për të parë procedurën se si ne i regjistronim mjekët e rinj për praktikën profesionale para dhënies së provimit të shtetit. Në Shkurt 2016, u bë një draft për të pasur nën kontroll jo në mënyrë të drejtperdrejt UMSH-në nga një institucion shëndetësor. **Gjë që u kundërshtua fort edhe nga urdhrat e tjerë.**

Ne kemi sqaruar kundërshtimin tonë, mbështetur në ligj. Por në të njëjtën kohë kemi theksuar se jemi të hapur të informojmë e të bashkëpunojmë, duke ofruar kontributin tonë brenda hapësirës ligjore, funksionit dhe misionit tonë.

Duke përfunduar, dua të theksoj se vështirësitë e shumta kërkojnë një angazhim më të madh nga të gjithë ne, duke tërhequr mendime dhe kontribute të gjithë bashkësisë së mjekëve, të ruajmë ç'ka është arritur dhe të përpiqemi të përgjigjemi më shumë e më mirë kërkesave që rriten çdo ditë.

Tiranë, 08.04.2016